



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:134327
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706678

K.Dh.Shk.II.nr.151/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.T. Abetarja, me seli në Gjilan, rr. '15 Qershori', kundër debitorit Komuna e Novobërdës, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1799/22 i datës 20.11.2023, me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit N.T. Abetarja, me seli në Gjilan, rr. '15 Qershori', ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1799/22 i datës 20.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1799/22 i datës 20.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Novobërdës, ashtu që anulohet Urdhri Përmbarimorë P.nr.428/22 të datës 03.06.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të priset në tërësi aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.1799/22 i datës 20.11.2023 dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarrim P.nr.428/22 të datës 03.06.2022 i Përmbarruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjiilan.

Debitorit nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se: Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datën 30.06.2022 ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshme – Faturës nr. FSM-22-000174, e datës 21.04.2022; Faturës nr. FSM-22-000172, e datës 11.05.2022; Faturës nr. FSM-22-000173, e datës 13.03.2022; Faturës nr. FSM-22-000022, e datës 21.01.2022; Faturës nr. FSM-22-000021, e datës 21.01.2022; Faturës nr. FSM- 22-000023, e datës 16.01.2022; Faturës nr. FSM-22-000024, e datës 13.01.2022; Faturës nr. FSM-22-000171, e datës 13.01.2022; Faturës nr. FSM-21-000443, e datës 16.12.2021; Faturës nr. FSM-21-000444, e datës 16.12.2021; Faturës nr. FSM-21-000442, e datës 16.12.2021; Faturës nr. FSM-21-000389, e datës 08.11.2021; Faturës nr. FSM-21-000388, e datës 08.11.2021; Faturës nr. FSM-21-000363, e datës 21.10.2021; Faturës nr. FSM-21-000164, e datës 22.10.2021; Faturës nr. FSM-21-000365, e datës 22.10.2021; Faturës nr. FSM-21-000313, e datës 02.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000312, e datës 02.09.2021; Faturës nr. FSM- 21-000282, e datës 01.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000281, e datës 01.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000283, e datës 01.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000280, e datës 01.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000284, e datës 01.09.2021; Faturës nr. FSM-21-000306, e datës 30.08.2021; Faturës nr. FSM-21-000236 e datës 29.06.2021 dhe Faturës nr. FSM-21-000307 e datës 01.08.2021, në shumën e përgjithshme prej 2,513.82€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për përmbarrim.

Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan, me Urdhri Përmbarimor P.nr.428/22 të datës 03.06.2022, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm – Faturat e lartcekura, i plotësojnë kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri, ka paraqitur prapësim debitori, duke theksuar se fatura mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarim është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që nuk janë dorëzuar asnjëherë tek debitori, të njëjtat nuk janë pranuar dhe se ju mungon vula e protokollimit, dhe nuk ka asnjë marrëveshje me kreditorin, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri për përmbarim i lëshuar nga përmbaruesi privat.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditorë, duke e kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim, duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor P.nr.428/22 të datës 03.06.2022 të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, KPPP.nr.1799/22 i datës 20.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Novobërdës, ashtu që anulohet Urdhri Përmbarimorë P.nr.428/22 të datës 03.06.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan, po ashtu, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë ka konstatuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësim dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas aktvendim të Gjykatës Komercial të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar.Me arsyetim se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument të besueshëm për faktin se nuk mund të vërtetohet që faturat e lartëcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar pranë debitorit, pasi që të njëjtat nuk mbajnë vulën e pranimit të debitorit, për më tepër gjykata gjenë se në anjërën nga faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhëri përmbarimor nuk është evidentuar si debitor Komuna e Novobërdës dhe rrjedhimisht faturat në fjalë nuk paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit ndaj këtu debitorit Komuna e Novobërdës.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182

paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejt se faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi nuk mund të vërtetohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori, pasi që të njëjtat nuk janë protokolluar në zyrën e pranimi të debitorit Komuna e Novobërdës, nuk mbajnë vulën e pranimi – protokollimit, e për më tepër faturat në fjalë nuk përmbajnë as emërtimin e debitorit si në faturë, ngase në faturë figuron vetëm debitori SH.F.M.U Hanumshahe dhe T.Z. dhe se mungon emërtimi i debitorit Komuna e Novëverdës, andaj dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme për përmbartim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht të vlefshme dhe se nuk kishin në ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbartimore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj. Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.151/24 dt. 20.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri